



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 05.05.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN “SHITESË KATI ME
KONSTRUKSION METALIK DHE RIKONSTRUKSION ZYRASH NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË”, BASHKIA
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin “Shtesë kati me konstruksion metalik dhe rikonstruksion zyrash në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë”, Bashkia Tiranë, me subjekt kërkuës Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturës bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuës vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN




Z. NASIP NAÇO

MINISTËR I DREJTËSISË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT